



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-049

Prishtinë, më 6 shkurt 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË TË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 6 SHKURT 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja, Sanije Berisha.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 30 janar 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 30 janar 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 30 janar 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryetari e njoftoi Kryesinë se aktualisht nuk ka projektligje të gatshme për lexim të parë, ndërsa vetëm dy projektligje janë për shqyrtim të dytë. Pra, nuk ka numër të mjaftueshëm të projektligjeve për të mbajtur seancë plenare këtë javë.

Ai propozoi që seanca e radhës të mbahet javën e ardhshme.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Kërkesë për lejimin e udhëtimit zyrtar të tre deputetëve të Kuvendit të Kosovës në Kroaci

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lartë, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit të Kosovës, në këtë përbërje: Lutfi Haziri, Burim Ramadani dhe Muhamet Mustafa, në Kroaci, prej 20-24 shkurt 2012.

2. Shpenzimet e qëndrimit, të akomodimit dhe të transportit të brendshëm prej Aeroportit Ndërkombëtar të Zagrebit, deri në hotel dhe anasjelltas, prej 21 - 23 shkurt 2012, mbulohen nga organizatorët - Shoqata "George C. Marshall" në Republikën e Kroacisë, së bashku me partnerin e Konferencave Konrad Adenauer Stiftung, ndërsa, shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit për dy netët e tjera (të cilat nuk i mbulon organizatori) për 20 dhe 23 shkurt 2012, si dhe kompensimi i mëditjeve, prej 20 deri më 24 shkurt 2012, për të lartpërmendurit në paragrafin 1 (një) të këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës

2. Njoftimi i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Turqi

Kryesia u njoftua me vizitën e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të realizuar në Turqi, prej 16 - 21 janar 2012.

3. Rekomandimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për shqyrtimin e mundësisë për përkrahje financiare të KMDLNJ-së

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e cekur më lartë lidhur me kërkesën e KMDLNJ-së, për përkrahje financiare, mori këtë

V E N D I M

Lejohet përkrahja financiare Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, në shumën prej 3.000 euro, për vazhdimin e qëndrueshëm të punës monitoruese për vitin 2012.

4. Rrjedha e shënimit të katër vjetorit të Pavarësisë

Nënkryetari i Kuvendit, zoti **Xhavit Haliti** e informoi në hollësi, Kryesinë e Kuvendit me planin për shënimit të 17 Shkurtit- Ditës së Pavarësisë, të cilin e miratoi Kryesia. Diskutimi i plotë është dhënë në transkript.

5. Kërkesa e deputetit Danush Ademi për vizitë në Gjermani

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lartë, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i deputetit të Kuvendit, Danush Ademi, në Gjermani, prej 11-16 shkurt 2012.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartpërmendurin në paragrafin 1 (një) të këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:35** minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale